



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2761 Prot.

Roskovec, më 08.04 2021

V E N D I M

Nr. 23, datë 08/04 /2021

“PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PËR MBROJTJEN CIVILE PËR NDËRTIMIN

EMERGJENT TË OBJEKTIT : “PËRFORCIM I URËS AUTO MBI KOLEKTOR , FSHATI SUK 2”

Në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 23 , neni 29 si dhe neni 54 , gërma dh , të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” të ligjit 68/2017 “Për financat e veteqeverisjen vendore“ neni 45 , të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH” i ndryshuar neni 44 , të udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, vendimit të Këshillit të Bashkisë ", të VKB nr.89 datë 02.12.2020 “Për miratimin e buxhetit , numrin maksimal të punonjësve të Bashkisë Roskovec dhe ndërmarjeve vartëse si dhe nivelin maksimal të pagave për vitin 2021” si dhe materialeve të sjellë nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe sektori i shërbimeve;Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

1. Miratimin e fondit prej **1,229,208 lekë** për ndërtimin emergjent për objektin : “Përforcim i urës Auto mbi kolektor , fshati Suk 2”.
2. Financimi do të përballohet nga fondi i mbrojtjes civile nga Transferta e pakushtëzuar sektoriale 2021.
3. Ngarkohet Nëpunesi Autorizues , sektori i shërbimeve dhe Drejtoria Ekonomike për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi në bazë të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 55 pika 6.

KRYETAR
Kadri Hyska





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 BASHKIA ROSKOVEC
 Sektori i Sekretarit- Arkivit

Model nr. 5

KARTELE SHOQERUESE E PRAKTIKES

Dergues Prejekturo
 07.04.

Nr. Prot. 36P/1 Data

Shkurtimi i lendes Kthim pergjigje

Per trajtim nga: (struktura te tjera te ngarkuara)	<u>Z. Evina Jiseta</u>
Me porosi:	<u>Z. Arlenda Hoxha</u>

Normal (7 dite) Prioritet (3 dite) Urgjent (brenda dite) Pa afat/per dijen Tjeter: _____ dite

Data 07.04.21 Nr. Prot. 2545/1

Nenshkrimi: (I TULLARI)

Nenshkrimi

Marrne dorezim: _____

Kalon per trajtim (struktura): _____

Me porosine: _____

Marrne dorezim: _____

Kalon per trajtim (struktura): _____

Me porosine: _____

Marrne dorezim: _____

Kalon per trajtim Specialisist: _____

Me porosine: _____

Trajtimi i materialit perfunduar me: _____

Trajtimi i materialit pranuar me: _____

Trajtimi i materialit miratuar me: _____

Trajtimi i materialit miratuar me: _____

Specialisti

Eprori ne shkalle hierarkike

Eprori ne shkalle hierarkike

Eprori ne shkalle hierarkike

12.04.2021



REPUBLIKA E SHQIPERISË
PREFEKTI QARKU FIER

Nr. 3687 Prot.

Fier, më 07.04.2021

Lënda: Kthim përgjigje për ligjshmërinë e vendimeve Nr 17, Nr 18 dhe 20, të Këshillit Bashkiak Roskovec datë 31.03.2021

Drejtuar: Znj. Majlinda BUFI

KRYETAR I BASHKISË ROSKOVEC.

Z. Kadri HYSKA

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK ROSKOVEC.

ROSKOVEC

Në përgjigje të shkresës suaj me Nr. 2545 prot. datë 01.04.2021, bazuar në Ligjin nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" neni 8 shkronja "a" dhe 16 pasi shqyrtuam ligjshmërinë e vendimeve të Këshillit Bashkiak Roskovec të marra në mbledhjen e datës 31.03.2021 si dhe dokumentacionin plotësues për vendimet konfirmojmë si më poshtë:

Vendimi nr 17, datë 31.03.2021 "Për miratimin e rregullores "për ngritjen, funksionimin dhe ndërveprimin e strukturave komunitare në Bashkinë Roskovec" Ju kthehet pasi nga ana e këshillit nuk është kryer këshillimi me bashkësinë sic kërkohet në ligjin Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar) neni 18 pika 2 ku parashikohet se: "*Këshillimi me publikun, në çdo rast, bëhet sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit, duke përdorur një nga format e nevojshme, si takimet e hapura me banorët e grupet e interesit, takime me specialistë, me institucione të interesuara dhe organizata jofitimprurëse ose nëpërmjet marrjes së nismës për organizimin e referendumeve vendore*".

Referuar rregullores së këshillit bashkiak Roskovec për "Konsultimin publik " viti 2020 neni 25 janë të parashikuara format e këshillimit me bashkësinë si më poshtë:

- a. takimet e hapura me banorët e grupet e interesit,
- b. takime me specialistë,
- c. takime me institucione të interesuara,
- d. takime me organizata jofitimprurëse, ose

e. nëpërmjet marrjes së nismës për organizimin e referendumeve vendore.

Nga ana juaj nuk është përdorur asnjë nga format e këshillimit me bashkësinë që kërkohet në ligj apo në rregullore.

Nga dokumentacioni i dërguar konstatojmë se keni aplikuar pjesërisht fazat e procesit të këshillimit me bashkësinë por nuk keni zbatuar takimet publike të këshillimit me bashkësinë (banorët e grupet e interesit, specialistë, OJF) fazë e detyrueshme dhe e rëndësishme për tu zbatuar në përputhje edhe me masat ligjore në fuqi kundër virusit Covid 19.

Për sa më sipër këshillimit publik është një proces i detyrueshëm për tu bërë nga këshilli bashkiak për rastin e parashikuara në nenin 54 shkronja "a" dhe mosbërja e këshillimit publik në format që kërkon ligji dhe rregullorja e këshillit e bën vendimin tuaj të paligjshëm

Për sa më sipër Vendimi nr 17 datë 31.03.2021 "Për miratimin e rregullores "Për ngritjen, funksionimin dhe ndërveprimin e strukturave komunitare në Bashkinë Roskovec" ju kthehet si në kundërshtim me Ligjin Nr. 139/2015 "për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar) neni 18 dhe rregulloren e këshillit bashkiak Roskovec "Për konsultimet publike" viti 2020.

Vendimi nr 18 "Për disa shtesa në vendimin nr 88 datë 22.11.2020 'Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2021' Nga verifikimi ligjor i vendimit dhe dokumentacioni i dërguar ju bëjmë me dije se:

Këshilli Bashkiak Roskovec nuk ka kryer këshillimin me bashkësinë sic kërkohet në ligjin Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar) neni 18 pika 2 ku parashikohet se: *"Këshillimi me publikun, në çdo rast, bëhet sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit, duke përdorur një nga format e nevojshme, si takimet e hapura me banorët e grupet e interesit, takime me specialistë, me institucione të interesuara dhe organizata jofitimprurëse ose nëpërmjet marrjes së nismës për organizimin e referendumeve vendore"* dhe neni 54 shkronja "f".

Referuar rregullores së këshillit bashkiak Roskovec për "Konsultimin publik " viti 2020, në nenin 20 pika 2 shkronja "c" parashikohet se:

"Këshilli mban së paku dy takime publike këshillimi me bashkësinë në rastet kur miraton taksat e tarifave vendore". Ky parashikim i detyrueshëm nuk është zbatuar nga ana juaj.

Gjithashtu në rregulloren për Konsultimi publik neni 25 parashikohen format e këshillimit me bashkësinë. Nga ana juaj nuk është zbatuar asnjë nga format e këshillimit me bashkësinë që kërkohet në ligj apo në rregullore.

Duke qenë se pika 2 e vendimit të Këshillit Bashkiak Roskovec i referohet vendosjes së një tarife të përkohshme ndaj ALBPETROL SHA në masën 50 000 000 leke i cili në këtë rast është edhe subjekti i interesuar drejtëpërdërtetë nga vendosja e kësaj tarife. Mos bërja e konsultimit me këtë subjekt në format që kërkon ligji dhe rregullorja e cënon vendimmarrjen tuaj.

Nga dokumentacioni i dërguar konstatojmë se keni aplikuar pjesërisht fazat e procesit të këshillimit me bashkësinë por nuk keni zbatuar takimet publike të këshillimit me bashkësinë (banorët e grupet e interesit, specialistë, OJF) fazë e detyrueshme dhe e rëndësishme për tu zbatuar.

Për pikën 2 të vendimit konstatojmë se nga ana e këshillit nuk është përcaktuar afati i tarifës së përkohshme, mënyrën e pagimit të tarifës.

Në relacion nuk jepet asnjë sqarim se çfarë është kjo tarifë e përkohshme, cilat janë arsyet që këshilli vendos tani për këtë tarifë, mungon akti i konstatimit nga ekspertë të fushës për ndotjen që ka shkaktuar kompania ALBPETROL sh.a në kanalet kulluese.

Për sa më sipër Vendimi Nr. 18 datë 31.03.2020 “Për disa shtesa në vendimin nr 88 datë 22.11.2020 ‘Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2021’”ju kthehet si në kundërshtim me Ligjin Nr. 139/2015 “për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar) neni 18 dhe rregulloren e këshillit bashkiak Roskovec “Për konsultimet Publike” viti 2020.

Vendimi nr 20, datë 31.03.2021 “Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve për programin buxhetor afatmesëm 2022-2024” Është në përputhje me Ligjin nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 41, pika 1; Ligjin nr 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 32; Ligjin nr 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 6, shkronja “ç”; Udhëzimin nr 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, neni 63.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

Baki BALA

